

Ay që kish për të marë gjakun që i humbur në shoqëri sepse kudo që të vinte do flisnin për të dhe e quanin burracak në rast vonese. Për të treguar përbuzjen kundrejt një personi të tillë që munt ndodhej në ndonjë dasmë ose festë, goitën e rakisë ja mbushnin për gjysmë edhe i epnin dorën e mëngjër në vënt të së djathtës. Me të tjera fjalë, shoqëria me zakonet e saj të këqia shumë herë bëheshe shkakëtare për vrasje të rea. S' është gjë e pakët për një malësor t' i thonë burracak dhe t' a përbuzin më ç' do vënt. Sikur edhe të mos kish qëllime për vrasje, një mentalitet i tillë e dëshpëron njerinë dhe e shtyn që të bëjë këtë punë të mërziut.

Të thomi se u vra nonjë prej shtëpisë të vrasësit dhe me këtë mënyrë u la gjaku. Atëhere ç' do ngjiste? Prapë do vazhdonte ndjekja mytyele, e cila gjer më në funt shkakëtonte prishjen e të dy palëve. Një luft' e pa prerë u sillte dëme të mëdha për veç humbjes të njeriut, sepse burrëria s' munt të punonte lirisht. Për këtë shkak hynin në mes të dy palëve miqtë, të cilët lithnin besë dhe kjo ish një kohë lirie dhe sigurimi për vrasësin. Miqtë dhe dorëzënësit që bënin hapat pranë shtëpisë të të vramit për "me lidhë besë" nuk kishin pagesë. Besa e katundit ka qënë për një kohë prej tri dhjetë ditsh dhe në këtë periudë në rast të